LIGJ
Nr.10 438, datë 28.6.2011

PËR PJESËMARRJEN E POLICISË SË SHTETIT NË MISIONE POLICORE, PAQERUAJTËSE DHE HUMANITARE JASHTË VENDIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka për objekt pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit në misione policore, paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit, duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kartën e Kombeve të Bashkuara, parimet e Organizatës së Atlantikut të Veriut, dokumentet e sigurisë së Bashkimit Europian dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Pjesëmarrja në misione policore, paqeruajtëse dhe humanitare

Me pjesëmarrje në misione policore, paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit, në zbatim të këtij ligji, kuptojmë:

1. Pjesëmarrjen e punonjësve të Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë në misionet policore ndërkombëtare.
2. Pjesëmarrjen në misione paqeruajtëse dhe humanitare ndërkombëtare.

Neni 3
Statusi i punonjësve të Policisë së Shtetit jashtë vendit

Dërgimi i punonjësve të Policisë së Shtetit jashtë vendit bëhet vetëm në rastet kur, paraprakisht, është arritur një marrëveshje ndërkombëtare për statusin e tyre në vendin ku do të ushtrojnë misionin.

Neni 4
Delegimi i autoritetit

Kompetencat e drejtimit dhe të kontrollit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, mund t’i transferohen një organizate ndërkombëtare.

Neni 5
Vendimi për pjesëmarrjen e punonjësve të Policisë së Shtetit në misionet policore, paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit

1. Vendimi për pjesëmarrjen e punonjësve të Policisë së Shtetit në misionet policore, paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit merret si më poshtë:
   a) deri në 100 punonjës policie, me vendim të Këshillit të Ministrave;
   b) mbi 100 punonjës policie, me ligj nga Kuvendi.
2. Misioni, kohëzgjatja, vendi i kryerjes së misionit, detyrat, efektet financiare dhe niveli i

pjesëmarrjes së Policisë së Shtetit në misionet policore, paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose me ligj, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij neni.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7044, datë 6.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bamir Topi